

SPAK nis verifikimin për gjyqtarët e shkarkuar nga vettingu

23 Qershor 2020 LAJME

Prokuroria e Posaçme Antikorrupsion ka nisur verifikimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Lartë të shkarkuar në të dyja shkallët e vettingut. Jo zyrtarisht mësohet se SPAK do të verifikojnë nëse mbi gjyqtarët e shkarkuar ka elementë të veprës penale si pastrim parash, korrupsion e fshehje pasurie për shkak të funksionit që kanë pasur. Bëhet fjalë për 12 dosje të tërhequra nga prokurori i SPAK, Edvin Kondili ndërsa lëvizja erdhi pas kallëzimit penal që avokati Fran Dashi depozitoi në Prokurorinë e Posaçme. Objekt kallëzimi janë deklaramet e kryera nga këta subjekte para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe vendimet e shkarkimit të tyre. Kallëzimi u regjistrua nga SPAK për veprën penale 'Refuzimi për deklarin, mosdeklari, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publik ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim'.